



**Republika e Kosovës**

Republika Kosovo

Republic of Kosovo



**Kuvendi i Komunës Istog**

Skupština Opštine Istok

Municipal Assembly Istog

Komititeti për Politikë dhe Financa / Komitet za Politiku i Financije / Policy and Finance Committee

2

**P r o c e s v e r b a l**

<b>Tipi i mbledhjes:</b>	Mbledhje e rregullt e KPF-së
<b>Data e mbajtjes:</b>	23.04.2018, në ora 10:00
<b>Mbledhjen e kryesoit:</b>	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
<b>Procesmbajtës:</b>	Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Kuvendit të Komunës.
<b>Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së</b>	Haki Podrimaj, Besa Ferati, Zenel Shatri, Eliot Kukiqi, Ardit Idrizaj, Ajshe Metaj.
<b>Mungojnë:</b>	
<b>Pjesëmarrës të tjera:</b>	Nënkyetari Lulzim Blakaj, Osmon Sadikaj, Hysni Mëxharraj, Jeta Blaj, Hysen Pelaj, Fjollë Berisha, Genc Ademaj, Enver Rugova, Isa Hoxha, Agim Haxhijaj.

**Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt - plotësim ndryshimit të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba, Nr. 01/2017;
3. Marrja e vendimit për bartjen e të hyrave vetanake prej vitit 2016, 2017 në vitin 2018;
4. Shqyrtimi i raportit financiar për muajt, Janar-Prill 2018;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për nismën e bashkëpunimit ndërkunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitet;
6. Marrja e vendimit për plotësimin dhe ndërrimin e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike lokale, Stacioni i Autobusëve;
7. Raporti i punës së Ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve" për periudhën 1 vjeçare , Prill 2017-Mars 2018.

**Diskutimet:**

**Kryesuesi – z. Qaush Balaj** - pëershëndet Nënkyetarin z. Lulzim Blakaj, anëtaret e Komitetit për Politikë dhe Financa, Drejtoret, Zyrtar të Administratës Komunale, përfaqësues të OSBE, mirë se keni ardhur ju faleminderit për pjesëmarrje.

Duke pasur parasysh se kuorumi për mbajtjen e mbledhjes së Komitetit për Politikë e Financa është arritur me lejoni që të shpallë të hapura punimet e mbledhjes se Komitetit për Politikë e Financa. Pyet nëse ka dikush ndonjë pyetje.

**Nënkyetari i Komunës** – përshëndet të gjithë të pranishmit dhe uron punë të mbarë, propozon një pikë për rend të ditës: Marrja e Vendimit për themelimin e inkubatorit të biznesit.

**Kryesuesi** – Hedhe në votim propozimin e Nënkyetarit. Kush është për miratim Miratohet pika e rendit të ditës Marrja e Vendimit për themelimin e inkubatorit të biznesit, unanim nga anëtaret e KPF-së, dhe i kalohet Kuvendit komunal.

Hedhe në votim rëndin e ditës. Kush është për miratim?

**Konstatojmë se rendi i ditës miratohet një zërit.**

**Vendimet:**

**Miratohet rendi i ditës nga KPF-së pa vërejtje**

**Personat përgjegjës për zbatim:**

**Afati për zbatim:**

#### Shqyrtimi i pikës 1.

**Diskutimet:**

**Kryesuesi**, vazhdojmë më pikën e parë të rendit të ditës, Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni. Pyete nëse dikush ka ndonjë pyetje apo diskutim rreth procesverbalit.

Pasi që nuk partë diskutime

Procesverbalini hidhet në miratim:

**Vendimet:**

**Miratohet Procesverbal i mbledhja e kaluar pa vërejtje,**

**Personat përgjegjës për zbatim:**

**Afati për zbatim:**

#### Shqyrtimi i pikës 2.

**Diskutimet:**

**Kryesuesi** - vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës, Projekt – Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba.

**Nënkyetari i Komunës** – Përshëndete të gjithë të pranishmit, prezanton dhe sqaron Projekt – Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba.

**Ardita Idrizaj, AAK** – përshëndet të gjithë të pranishmit, këtu tek lindjet në spital as një fëmije nuk e lëshojnë me dal nga spitali pa e regjistruar, pse të jetë gjoba.

**Nënkyetari i Komunës** – kemi ende raste të fëmijëve të pa regjistruar, për shkaqe të ndryshme

**Hysni Maxharraj, Drejtor i Drejtoratit për Buxhet dhe Financa** – përshëndet të gjithë të pranishmit, prezanton dhe sqaron Rregulloren me propozimet e dala nga Dëgjimi Publik.

**Nënkyetari i Komunës** – sqaron neni 14 të rregullores.

**Eliot Kukiqi, AAK** – përshëndet të gjithë të pranishmit, pyete familjet e veteraneve a lirohen

nga pagesa.

**Hysni Maxharraj, Drejtor i Drejtoratit për Buxhet dhe Financa** – sqaron tek neni 14 të shtohet pika 8 vërtetimet sipas kërkesës, qe të mos paguhen të gjithë vërtetimet.

**Zenel Shatri, LDK** – përshëndet të gjithë të pranishmit, tek neni 14 të harmonizohet me Ligjet në fuqi.

**Nënkyetari i Komunës** – thotë tek neni 8 pika 9.2 të përjashtohen nga pagesa rastet e zjarreve në shtëpi të mos paguhen djegja e shtëpive, të shtohet të neni 14.

**Kryesuesi** – pasi që diskutime tjera nuk ka: hedh në miratim miratohet një zëri.  
**Vendimet:**

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime të tjera, **KPF–ja vendosi**: që miratohet Projekt -Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba, dhe e njejtë i kalohet Kuvendorit për shqyrtim dhe miratim.

<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Afati për zbatim:</b>	Deri në mbledhjen e kuvendit

### Shqyrtimi i pikës 3.

**Diskutimet:**

**Kryesuesi** - po vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës. Marrja e vendimit për bartjen e të hyrave vetanake prej vitit 2016, 2017 në vitin 2018.

**Hysni Maxharraj, Drejtor i Drejtoratit për Buxhet dhe Financa** – prezanton dhe sqaron vendimit për bartjen e të hyrave vetanake prej vitit 2016, 2017 në vitin 2018.

**Besa Ferati, LDK** – përshëndet të gjithë të pranishmit, tek bartje projekti pllaka për Fadil Feratin që tri herë po bartën nga viti në vite 20 mijë euro, është premtuar që vitin e kaluar të bëhet por nuk është ndërtuar. Thekson që të propozohet një shumë tjetër sa mund ta mbulojë realizimin e këtijë projekti ose të hiqet krejt.

**Nënkyetari i Komunës** – thekson së këtë projekt duan ta qesin në konkurs dhe kush do ta fitoj para kemi nda vetëm sa për ta filluar punën.

**Besa Ferati LDK** – në marrëveshjen që kemi ber është thënë që do të marohet një bust e jo një pllakë, dhe me ekspertet që kemi folua na kanë thënë që për një bust duhen mjete ma shumë sa tri herë kjo shumë.

**Ajshe Metaj PDK** – pyete vazhdimi i projekteve në fshatin Kamenicë sa duhet të shtohet nga këto mjete të cilat janë të parapamë dhe a do të rregullohet sivjet.

**Nënkyetari i Komunës** – tani mjete ka të mjaftueshme për këtë kanal,

**Ardita Idrizaj AAK** – pyete rruga të lagja Idrizan në fshatin Lubozhdë kur do të asfaltohet,

**Nënkyetari i Komunës** – së pari duhet të lidhen të gjitha shtëpitë në kanalizim dhe pastaj mund ta shtrojmi rrugën.

**Ardita Idrizaj AAK** – po ato familje të cilat ende nuk janë lidhur në kanalizim janë raste sociale dhe nuk mund të lidhen pasi që nuk kanë mjete financiare.

**Enver Rugova, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime Publike** – kjo rrugë do të hy në projekt por problemi është se si do të kyqen ato familje në kanalizim.

**Zenel Shatri LDK** – lagja bregu në Tomoc kur do të hy si projekt kanalizimi aty ka probleme të mëdha.

**Eliot Kukiqi AAK** – në gurrakoc nuk ka as një projekt, mirëmbajtja e rrugëve është e nevojshme dhe busti i Fadil Feratit kurë do të nertohetë.

**Nënkyryetari i Komunës** – busti i Fadil Feratit do të jetë të komuna.

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim, miratohet një zëri.

#### Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi: që një zëri propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake prej vitit 2016, 2017 në vitin 2018, dhe e njëjtë i kalohet kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit

#### Shqyrtimi i pikës 4.

#### Diskutimet:

**Kryesuesi** - po vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës, Shqyrtimi i raportit finansiar për muajt, Janar-Prill 2018.

**Osmon Sadikaj, zyrtar kryesor finansiar** – përshtendet të gjithë të pranishmit dhe bene prezantimin dhe sqarimin e shqyrtimi i raportit finansiar për muajt, Janar-Prill 2018.

**Ardita Idrizaj AAK** – pyete pse nuk e kanë pagesën e njëjta të gjitha kopshet e fëmijëve si në Istog po ashtu edhe në preferi.

**Osmon Sadikaj, zyrtar kryesor finansiar** – kjo është e miratuar në kuvendi e ka miratuar dhe ka pasur edhe dëgjim publik.

**Eliot Kukiqi, AAK** – pyete 4457 euro si u shpenzuan këto mjete naftë për ngrohje qendrore.

**Hysni Maxharri, Drejtor i Drejtoratit për Buxhet e Financa** – në këtë shumë hynë edhe shtëpia e pleqve në Gurrakoc si dhe krejt borxhi që është paguar për ngrohje në muajin mars.

**Ajshe Metaj, PDK** – pyete a ka menaxher që i menaxhon dhe i kontrollon shkollat shpenzimet e shkollave.

**Osmon Sadikaj, zyrtar kryesor finansiar** – të gjitha shkollat e kanë buxhetin e tyre i cili menaxhohet nga drejtori i shkollës, komuna e benë regjistrimin e asetëve që janë evidentuara.

**Ajshe metaj PDK** – ka pasur raste kur gjenerator nuk ka pasur në shkollë dhe është paguar karburante.

**Eliot Kukiqi, AAK** – të gjobatë kemi vetë 40 euro dënim të inkasume për pije alkolike.

**Kryesuesi** – pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim, miratohet një zëri.

**Vendimet:**

**Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi:** që të miratoj një zëri Raportin finansiar për muajt, Janar-Prill 2018, dhe e njëjtë i kalon kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim.

**Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:**

Deri në mbledhjen e kuvendit

### Shqyrtimi i pikës 5.

**Diskutimet:**

**Kryesuesi** - po vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë, materialin keni pasur mundësi ta analizoni pasi që ju është dërguar më rend të ditës.

**Nënkyetari i Komunës** – bene prezantimin dhe sqarimin e Propozim-vendimit për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë;

**Kryesuesi** – pyete nëse dikush nga anëtaret e KPF-së dëshiron fjalën. Hedh në miratim: kush është për? Konstatojmë së Propozim-Vendimit për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë, miratohet një zëri.

**Vendimet:**

**Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi:** së miratohet një zëri Propozim-Vendimit për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë;, dhe i njëjti i kalohet kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim.

**Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:**

Deri në mbledhjen e kuvendit

### Shqyrtimi i pikës 6.

**Diskutimet:**

**Kryesuesi** - po vazhdojmë më pikën e gjatë të rendit të ditës, Marrja e vendimit për plotësimin dhe ndërrimin e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike lokale, Stacioni i Autobusëve;

**Nënkyetari i Komunës** - bene prezantimin dhe sqarimin e Propozim Vendimit për plotësimin dhe ndërrimin e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike lokale, Stacioni i Autobusëve, Komisioni përbëhet prej 3 anëtresh 1 Drejtori i Sherbimeve Publike dhe 2 Nga Anëtaret e Kuvendit.

**Zenel Shatri, LDK** – propozoj që anëtaret e kuvenit të jenë 1 nga LDK dhe 1 nga AAK pasi që jemi partit me me shumë përfaqshuesë në Kuvend.

**Kryesuesi** – hedhe në miratim propozim vendimin për plotësimin dhe ndërrimin e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike lokale, Stacioni i Autobusëve; Miratohet unanimisht nga KPF-ja.

**Vendimet:**

**Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi:** miratohet unanim, Propozim

vendimit për plotësimin dhe ndërrimin e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike lokale, Stacioni i Autobusëve; dhe të njëjtat i kalohet kuvendor komunal për shqyrtim dhe miratim.

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendor

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendor

#### Shqyrtimi i pikës 7.

##### Diskutimet:

**Kryesuesi** - po vazhdojmë më pikën e shtatë të rendit të ditës, Raporti i punës së Ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve" për periudhën 1 vjeçare, Prill 2017-Mars 2018.

**Enver Rugova, Drejtor i Drejtoratit për Sherbime Publike** - bene prezantimin dhe sqarimin e Raporti i punës së Ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve" për periudhën 1 vjeçare, Prill 2017-Mars 2018,

**Kryesuesi** - hedhe në miratim Raportin e punës së Ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve" për periudhën 1 vjeçare, Prill 2017-Mars 2018;  
Miratohet unanimisht nga KPF-ja.

##### Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF - vendosi: miratohet unanim, Raporti i punës së Ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve" për periudhën 1 vjeçare, Prill 2017-Mars 2018, dhe të njëjtat i kalohet kuvendor komunal për shqyrtim dhe miratim.

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendor

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendor

#### Shqyrtimi i pikës 8.

##### Diskutimet:

**Kryesuesi** - po vazhdojmë më pikën e tetë të rendit të ditës, Marrja e Vendimit për themelimin e inkubatorit të biznesit.

**Nënkryetari i Komunës** - bene prezantimin dhe sqarimin e Propozim Vendimit për themelimin e inkubatorit të biznesit.

**Kryesuesi** - hedhe në miratim propozim vendimin për themelimin e inkubatorit të biznesit.;  
Miratohet unanimisht nga KPF-ja.

##### Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF - vendosi: miratohet unanim, Propozim vendimit për themelimin e inkubatorit të biznesit, dhe të njëjtat i kalohet kuvendor komunal për shqyrtim dhe miratim.

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendor

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendor

## **DISKUTIME**

Kerkesë nga anëtaret e KPF-së kërkes për lloptopo .

Kërkjojn që procedura e lloptopve të përshpejtohet dhe mundesisht në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të ju shprendahen lloptopetë për të gjithë anëtaret e Kuvendit të Komunës.

**Kryesuesi** - para mbylljes së mbledhjes konstaton kuorumin prezentë ishin të gjithë anëtar e Komitetit për Politik e Financa, ju faleminderit për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë për këtë mbledhje.

Shpall të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

**Mbledhja përfundoj :** 13.00